



Prishtinë: 16.03.2017

Kodi i ZRRE-së: V_901_2017

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1556_02_17**;
- Ankesa e konsumatorit e datës **27.02.2017**

në seancën e mbajtur më datë 16.03.2017, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit K. H., nga Prishtina me shifër DPR 90053863 si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_1424_11_15 i datës 30.11.2015.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 27.02.2017 ka pranuar ankesën e parashtruar nga konsumatori Kudret Hasani, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkallës së parë për këto shkaqe: Shkelje e dispozitave procedurale, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të së drejtës materiale. Konsumatori në ankesë ka theksuar se në vendimin e atakuar ekzistojnë shkelje të dispozitave procedurale dhe gabim në zbatimin e dispozitave të së drejtës materiale për faktin se DMK/ZRRE ka vendosur në kundërshtim me dispozitat e nenit 14 paragrafi 1 pika 1 dhe paragrafi 2 pika 1 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë pasi që ankesa ime është dorëzuar në ZRRE me datë 26.02.2015 ndërsa për ankesën në fjalë është vendosur me datën 30.11.2015 duke i kaluar afatet ligjore sipas kësaj rregulle.

Lidhur me konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, DMK/ZRRE ka vendosur në mënyrë të njëanshme dhe jo të drejtë, kjo për faktin pasi që vendimi i saj bazohet vetëm në procesverbalin e ashtu siç thuhet inspektimit të KESCO-së të datës 06.02.2015. Po ashtu në ankesë theksohet se DMK/ZRRE ka vepruar në mënyrë të njëanshme pasi që nuk ka dal për të inspektuar pikën matëse për të vërtetuar më drejt gjendjen reale. Konsumatori ka pasqyruar shpenzimet e bëra për periudhën dhjetor 2014 vlera 30€, nëntor 2015 vlera 35€, si dhe periudha dhjetor 2015 vlera 70.80€, dhe mbi bazën e kësaj konsumatorit thekson se njehsori elektrik nuk është në rregull. Konsumatori në ankesë kërkon që të aprovet ankesa e tij dhe të anulohet vendimi i shkallës së parë.



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 16.03.2017 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejt dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i ZRRE-së, ka analizuar dhe shqyrtuar me kujdes të gjitha pretendimet ankimore të konsumatorit të theksuara në ankesë por që nuk ka vërtetuar me asnjë element se konsumatori është i dëmtuar dhe ngarkuar me ndonjë vlerë financiare më tepër se sa shpenzimi i energjisë elektrike të bërë në këtë pikë matëse.

Bordi ka analizuar edhe të gjitha konstatimet e theksuara nga shkalla e parë lidhur me gjendjen e shpenzimit të energjisë elektrike dhe me këtë ka vërtetuar se gjendja e shpenzimit të energjisë elektrike e njehsorit elektrik nr. 39053863 është TL=003991 kWh dhe TU=003129 kWh është në përputhje me gjendjen e shpenzimit të energjisë elektrike të evidentuar në rrjedhën e energjisë elektrike për muajin 01/2015 dhe 02/2015. Po ashtu janë analizuar edhe listat e leximit të kësaj pike matëse dhe nga kjo është vërtetuar se konsumatori ka lexim dhe faturim të saktë, gjithashtu edhe gjendja e shpenzimit të evidentuar në listat e leximit përputhet me gjendjen e shpenzimit të evidentuar në rrjedhën e energjisë elektrike aktive.

Lidhur me pretendimin e konsumatorit të theksuar në ankesë se organi i shkalles së parë ka vepruar njëanshëm pasi që nuk ka inspektuar pikën matëse për Bordin është i paqëndrueshëm pasi që kemi vërtetuar se KEDS saktësisht ka respektuar nenin 23 paragrafin 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji dhe si rezultat i kësaj ka qenë e panevojshme që të dilet në pikën matëse për inspektim shtesë pasi që të gjitha analizat e bëra nga shkresat e lëndës e vërtetojnë faktin se KEDS ka vepruar konform dispozitave ligjore në fuqi. Për më tepër punëtorët e KEDS kanë autorizimet ligjore për të inspektuar pikat matëse të konsumatorëve dhe përgjegjësi ligjore që të bëjnë konstatime të sakta varësisht nga gjendja që vërtetohet në vend të caktuar.

Bordi ka analizuar edhe pikën tjetër të kundërshtimit ku theksohet se janë shkaktuar vonesa nga organi i shkallës së parë në shqyrtimin e ankesës pasi që konsumatori ka parashtruar ankesë me datë 26.02.2015, ndërsa zgjidhja e ankesës është bërë me datë 30.11.2015. Lidhur me këtë Bordi ka kuptuar shqetësimet e konsumatorit, por që ka konstatuar se vonesa e tillë për atë periudhë kohore të mos shqyrtimit të ankesës nuk ka shkaktuar ndonjë dëm direkt të konsumatori pasi që i njëjti në bazë të dispozitave ligjore ka qenë i mbrojtur nga DMK/ZRRE për mos shkyçje për derisa nuk është shqyrtuar ankesa e tij. Gjithashtu bordi ka konstatuar se duke marr për bazë numrin e madh të ankesave të regjistruara në DMK/ZRRE dhe ngarkesave të shumta që ka ky departament një vonesë e tillë ka qenë e arsyeshme duke i marr për bazë të gjitha këto rrethana.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejt dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 16.03.2017 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimet të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Krenar Bujupi, u.d. kryesues

Arsim Janova, anëtar

Besim Sejfiqaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit K. H. dhe
- KESCO-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.